



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Orahovac

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural  
Uprava za Poleprivredu, Sumarstvo i Ruralni Razvoj  
Department of Agriculture, Forestry and Rural Development

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E ORAHOVCIT - OPŠTINA ORAHOVAC  
Drejtoria për Administratë të përgjithshme  
Odaljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. i prot. 469 Mb. 26.04.2019  
Br. prot. Dt. 2019  
RAHOVEC - ORAHOVAC

# RAPORT I PUNËS

## TM1/2019



## PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA .....	2
DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL .....	3
Projektet e investimeve kapitale .....	4
PËRFUNDIM .....	5

## DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural janë sektorët kryesor të cilët mund të kontribuojnë dukshëm në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit.

Komuna e Rahovecit përmes politikave dhe strategjive zhvillimore është orientuar në mbështetje të faktorëve të prodhimit, në stimulimin e fermerëve dhe në krijimin e një ambienti sa më të favorshëm zhvillimor. Këto politika dhe strategji janë duke krijuar mundësi që të arrihet një zhvillim i qëndrueshëm dhe një shfrytëzim shumë më efikas i resurseve natyrore të cilat i posedon komuna jonë.

Fillimi i vitit është karakterizuar me përpilimin e planit të punës për vitin 2019, plani i hartuar është mjaft ambicioz i cili ka ngërthyer në vehte aktivitete të shumta në kuadër të drejtorisë së bujqësisë. Në kuadër të këtij plani është bërë edhe planifikimi i aktiviteteve, i ndarë në periudha tremujore.

### Aktivitetet në periudhën: janar, shkurt, mars

Në kuadër të drejtorisë së BPZHR-së, nga janari janë realizuar një mori aktivitete. Ndër më kryesoret do të paraqiten të specifikuar sipas kohës në të cilën kanë ndodhur.

- Pranim i aplikacioneve për subvencionim të qumështit për tremujorin e katërt të vitit 2018 për fermerët blegtor ( MBPZHR hap thirrjen në baza 3 mujore, Drejtoria e BPZHR-së pranon aplikacionet dhe të njëjtat i dorëzon në Ministri për pagesë).
- DBPZHR ka ndërmarr masat dhe është përgatitur me kohë për hapjen e thirrjeve nga MBPZHR për pagesa direkte (jemi kujdesur që të furnizohemi me material administrativ për të përballuar fluksin e madh të fermerëve),
- Lidhur me pranimin e aplikacioneve, kemi kryer të gjitha përgatitjet rreth funksionalizimit zë zyrave në dy qendrat më të mëdha të komunës sonë për aplikim të fermerëve atë në Ratkoc dhe Krushë e Madhe. Me kohë jemi pajisur me qasjet e nevojshme në të gjithë softverët që janë të lidhur me plotësim të dokumenteve që kërkohen nga MBPZHR. Poashtu leje e veçant nga Agjencioni Kadastral i Kosovës për mundësinë e nxerrjes së dokumenteve të pronësisë edhe në këto dy qendra. E gjithë kjo me të vetmin qëllim për të ju lehtësuar fermerëve të komunës sonë këtë proces.
- Poashtu jemi përgatitur dhe kanë përfunduar me kohë procedurat për rritje të stafit në drejtori për pagesa direkte (janë pranuar 5 zyrtarë të rinj me kontratë për punë specifike të cilët janë trajnuar dhe aftësuar për përdorim të programit të ministrisë gjatë procesit të aplikimit dhe digjitalizimi i parcelave),
- Në bashkëpunim me organizatën IADK me të cilën kemi të nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi kemi implementuar disa projekte si:
  - Projekti për trajnim të të rinjëve në sektorin e bujqësisë për grupmoshat 18-29 vjeç,
  - Aplikimi dhe shpërndarja e granteve për të Riadhesuarit,
  - Grantet në sektorin e Bimëve Mjeksore Aromatike – BMA.
- Në bashkëpunim me Qendrën Grumbulluese “ Agrocelina” është organizuar takim me fermerë të komunës sonë. Në këtë takim është paraqitur planifikimi i QG “Agrocelina” për vitin 2019 dhe u është prezantuar oferta për eksport fermerëve në mënyrë që të lidhen kontratat me këtë Qendër Grumbulluese.

- Dita Ndërkombëtare Pyjeve - Në bashkëpunim me Asociacionin e Pronarëve Privat të Pyjeve është organizuar Dita Ndërkombëtare e Pyjeve, janë siguruar 1,000 fidane për komunën e Rahovecit të cilat janë mbjell në lokacione ku janë përkujtuar të rënë për liri me moton “ Një fidan, një kujtim”.
- Në sektorin e blegtorisë, në bashkëpunim me Agjencionin e Ushqimit dhe Veterinës është kryer repelimi i kafsheve të komunës sonë për parandalimin dhe mbrojtjen nga rriqrat (gjithsej 6,147 gjedhe 12,140 dele dhe 1,402 dhi në 33 fshatra dhe qytet).
- Janë organizuar dy trajnime për fermerë, njëri në sektorin e Blegtorisë dhe tjetri në atë të Bletarisë në kuadër të shërbimeve këshillimore që funksionon si urëlidhëse në mes të Ministrisë dhe fermerëve,
- Në bashkëpunim me drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, janë zhvilluar procedurat për dhënie të pronës komunale me qira.
- Pranimit dhe përgjigje ndaj kërkesave të ndryshme nga qytetarët, si dhe
- Shërbime të tjera në kuadër të drejtorisë si: Vërtetim për fermer, NIF, ndërrim i destinimit të tokës bujqësore, vlerësim të dëmeve të shkaktuara në sektorin e bujqësisë etj.

## Projektet e investimeve kapitale

Qysh në fillim të vitit kanë rifilluar punimet në projektet ku kemi kontratë me Operatorët Ekonomik.

- Ka vazhduar ndërtimi i serave të pa përfunduara, ky projekt pritet të përfundoj në fund të muajit prill.
- Me përmirësimin e kushteve atmosferike kanë rifilluar punimet edhe në projektet e kanaleve të kullimit si: Kullimit i tokave bujqësore në Malësi të Vogël, Gexhë, Ratkoc,
- Projekti për uljen e nivelit të përroit në fshatin Celinë, projekti ka vazhduar edhe përkundër faktit se gjatë punimeve janë shfaqur disa probleme, si është rasti me nënkalimin të hekurudha, pengesat e gypëve të sistemit të ujitjes, por që tani janë tejkaluar dhe projekti është në fazën përfundimtare.
- Në projektin “Ndërtimi i infrastrukturës për festivalin dhe tregun e rrushit” janë lryer të gjitha pozicionet dhe Operatori Ekonomik ka paraqit kërkesë për pranim teknik. Kemi formuar komisionin i cili ka filluar të inspektoj punimet dhe është në fazën e përpilimit të raportit. Me përfundimin e fazës së parë do të fillojnë procedurat për fillimin e fazës së dytë ku theksi do të bie te ndërtimi i shtëpizave (tezgëve) prej druri që shërbejnë për ekspozim dhe shitje të produkteve bujqësore.
- Projekti i kullimit të tokave bujqësore në Xërxë edhe përkundër presionit të vazhdueshëm akoma nuk ka filluar pasi Operatori Ekonomik që ka kontratë të nënshkruar me komunën e Rahovecit ka has në probleme me banorët ku do të ndërtohet kanali. Banorët kanë parashtruar kërkesë që kanali në segmentin përgjatë rrugës të ndërtohet i mbyllur. Ne e kemi aprovuar këtë kërkesë pasi kemi konsideruar se përmban arsyeshmëri dhe shumë shpejt do të ketë zhvillime edhe në këtë projekt

## PËRFUNDIM

*Ky raport përmbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe raportuese.*

***Duke u bazua në planin e punës kemi devijim nga ajo çka ne kemi planifikuar pasi që periudha e parë që përfshinë muajt janar, shkurt dhe mars kemi paraparë që të zhvillohet procesi i aplikimit për pagesa direkte-subvencione në kuadër të MBPZHR-se, dihet që akoma nuk është hapur thirrja dhe për këtë arsye kemi mospërbushje të planit të punës.***

*Kontakti me qytetarët dhe me grupet e interesit për të trajtuar dhe zgjidhur së bashku kërkesa, nevoja dhe interesa të tyre, është i vazhdueshëm.*

*Kemi krijuar raporte të mira me OJQ-të, me grupe të ndryshme, profesionist të fushave, me theks të veçant inxhinier të bujqësisë ku kemi pranuar këshilla, vërejtje dhe ide në mënyrë që të përmirësohemi dhe të zhvillojmë bujqësinë përditë e më mirë.*

05.04.2019

Rahovec

DREJTORI I DBPZHR-së

  
Berat Duraku